

KONTRATË SHITJE

(Kuotash të Shoqërisë)

Në Tiranë, sot më datë 01.02. 2024, në zyrën e shoqërisë "Bigalb Group" sh.p.k, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në veçanti në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, lidhet kjo kontratë huaje midis palëve të mëposhtme:

PALA E PARË: Z. Telat Arapi, i biri i Sherifit, i datëlindjes 06.08.1961, i lindur në Delvinë, Sarandë, dhe banues në Sarandë, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) me Nr.Personal G10806062E, që këtu e në vijim. "Shitësi"

PALA E DYTË: Z. Bahri Shaqiri, i biri i Femiut, i datëlindjes 08.06.1970, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 034140492 dhe nr personal H00608054R, që këtu e në vijim "Blerësi"

HYRJE

A. Shoqëria "Big S3" shpk, është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKB më datë 16.05.2019, pajisur me nipt L94116808Q, me seli në adresën *Lagja nr.3, Pallati nr.66, shkalla 1, Sarandë*, me ortakë:

2.1.1 Shoqëria "BIGALB GROUP":	Numri i Pjesëve 1 (një); Pjesëmarrja në përqindje 51%;
2.2.1 Z. Telat Arapi:	Numri i Pjesëve 1 (një); Pjesëmarrja në përqindje 49%

B. Palët kanë rënë dakort që një pjesë të kuotave të zotëruara nga Shitësi, të kalojnë tek Blerësi mbas firmosjes së kësaj kontrate.

C. Ortaku, Shoqëria "BIGALB GROUP" shpk, me vendimin Nr. 03 të datës 01.02.2024, në mënyrë të shprehur ka dhënë aprovimin e saj për tjetërsimin e kuotave

Duke vlerësuar bashkëpunimin dhe interesin e ndërsjellë, palët bien dakort për redaktimin e kësaj Kontrate Shitje si më poshtë:

Neni 1

Baza Ligjore

1.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, më posaçërisht Nenet 659 e vijues të tij;

1.2 Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", më posaçërisht nenet 72-75 të tij.

Neni 2

Objekti

2.1 Shitësi do t'i shesë Blerësit, një pjesë të kuotave të tij, në masën në masën e 24% të kapitalit, nga totali prej 49% (dyzetë e nëntë për qind) që Shitësi zotëron në shoqërinë Big S3.

2.2 Mbas shitjes së kuotave, Shoqëria "Big S3" shpk, do të zotërohet nga ortakët në si më poshtë:

1. Shoqëria "BIGALB GROUP": Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 51% (pesëdhjetë e një për qind);
2. Z. Telat Arapi: Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 25% (njëzet e pesë për qind);
3. Z. Bahri Shaqiri: Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 24% (njëzet e katër për qind).

Neni 3

Afati

3.1 Kuotat kalojnë në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Neni 4

Vlera e shitjes

4.1 Kuotat do të shiten me vlerën nominale prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 5.1 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me kuptimin dhe realizimin e kësaj kontrate, do ta zgjidhin me mirëkuptim.
- 5.2 Në rast se mosmarrëveshjet e mundshme nuk zgjidhen me mirëkuptim, secila nga palët mund t'i drejtohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
- 5.3 Legjislacioni i zbatueshëm do të jetë legjislacioni shqiptar.

Neni 6


Të tjera

- 6.1 Kontrata lexohet nga ne palët dhe pasi gjendet konform ligjit dhe vullnetit tonë të lirë, e nënshkruajmë atë rregullisht.
- 6.2 Kontrata redaktohet në 2 kopje, me fuqi të njëjtë.
- 6.3 Bashkangjitur dokumentat:
 1. Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë "Big S3" shpk;
 2. Vendim Nr. 03, datë 01.02.2024 i Shoqërisë "Big S3" shpk;
 3. Dokumentat ID të palëve

PALËT:

SHITËSI

Z. Telat Arapi



BLERËSI

Z. Bahri Shaqiri

